

**Akademik Teki BIÇOKU**  
Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

**I nderuari zoti Enver Hoxhaj Ministër i Arsimit – Shkencës dhe  
Teknologjisë**

**I nderuari zoti Rexhep Ismajli, kryetar i Akademisë së Shkencave  
dhe të Arteve të Kosovës**

**Të nderuar zonja e zotërinj,**

Është kënaqësi e veçantë për mua të marr pjesë dhe të përshëndes në emër të akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kremtimin e këtij jubileu të 130- vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të kësaj ngjarjeje nga më të rëndësishmet në historinë kombëtare të shqiptarëve.

E themeluar në Prizren, më 10 qershor të vitit 1878, nga personalitetet më të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të asaj periudhe, Ymer Prizreni, Abdyl Frahsëri, Pashko Vasa, Ali pashë Gucia, Ahmet Koronica, Sulejman Vokshi, Iljaz pashë Dibra, Zija Prishtina, Mehmet Ali Vrioni, Musatafa pashë Vlora, Hasan pashë Tetova, Sheh Mustafa Tetova, Shuaip Spahia, Ali Ibra e mjaft të tjerë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shndërrua në një organizatë politike mbarëshqiptare që e shtriu ndikimin e pushtetin e saj në të gjitha viset shqiptare.

Duke vepruar në periudhën e Krizës Lindore (1875-1881), kur për shkak të vendimeve të padrejta të Traktatit të Shën Stefanit

dhe Kongresit të Berlinit, shqiptarëve u qëndronte mbi krye rreziku i copëtimit përfundimtar të trojeve amtare, Lidhja e Prizrenit ngrii në këmbë gjithë shqiptarët, kundërshtoi me të gjitha mjetet vendimet e Kongresit të Berlinit, të cilat, me të drejtë i denoncoi "si një krim historik dhe moral" ndaj shqiptarëve.

Nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit shqiptarët gjatë pothuajse katër vjetëve (1878-1881) zhvilluan një luftë të pashembullt dhe njëherazi të pabarabartë, me armë dhe me mjete diplomatike për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe për bashkimin e trojeve të saj në një shtet të vetëm kombëtar. Në luftën për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Atdheut Lidhja e Prizrenit veprroi me energji të jashtëzakonshme. Veprimtaria e saj diplomatike dhe ushtarake për paprekshmërinë e kufijve të veriut dhe të jugut u shndërrua në një çështje të përgjithshme kombëtare.

Vendosmëria dhe heroizmi me të cilët Lidhja dhe forcat e saj vullnetare mbrojtën viset shqiptare, Plavën, Gucinë, Hotin, Grudën e Ulqinin në Veri të Shqipërisë dhe Çamërinë në Jug të saj, tronditën jo vetëm qarqet shoviniste të shteteve fqinjë dhe sundimtarët osmanë, por edhe Fuqitë e Mëdha, që u detyruan t'i ndryshonin disa herë vendimet e forumeve të tyre për kufijtë e Shqipërisë.

Lidhja e Prizrenit për herë të parë në historinë e Lidhjes Kombëtare Shqiptare përpunoi një platformë politike përparimtare e demokratike, që parashikonte çlirimin e shqiptarëve nga robëria thuajse pesëshekullore osmane nëpërmjet formimit të një shteti të bashkuar kombëtar, që do të ishte një dhe i pandarë.

Lidhja e Prizrenit ka hyrë përgjithmonë në historinë dhe në jetën e kombit shqiptar, si një organizatë politike që u ngrii mbi dasitë fetare dhe krahinore, bashkoi nën drejtimin e saj gjithë shqiptarët dhe krijoi kështu një unitet të vërtetë politik dhe kombëtar të popullit shqiptar, të mbështetur në interesat e përbashkëta të të gjitha forcave shqiptare të vendit, për mbrojtjen e tërësisë së Atdheut dhe për çlirimin e tij.

Vepra, që Lidhja e Prizrenit kreu në rrafshin kombëtar dhe në atë ndërkombëtar ruan vlerën e vet edhe sot, jo vetëm si një ngjarje historike, por edhe në rrafshin politik, kombëtar. Megjithëse i takojnë një periudhe disa të largët, këto përpjekje të Lidhjes së Prizrenit për mbrojtjen e paprekshmërinë së territoreve shqiptare dhe për formimin e një shteti të bashkuar kombëtar, janë ende shumë të afërta për ne për hir të jehonës që patën në brezat pasardhës, jehonë që ndihet edhe në ditët tona. Idetë dhe veprimtaria e Lidhjes do të mbeten të gjalla si një udhërrëfyes për të ardhmen e kombit shqiptar.

Duke kremtuar 130-Vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të gjithë ne shqiptarët shprehim sot kënaqësinë e veçantë që ky Jubile i madh përkoi me një nga ngjarjet më të mëdha në historinë e jetën e shqiptarëve të Kosovës dhe të të gjithë komtit tonë, me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës nga Kuvendi i saj më 17 shkurt të vitit 2008.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës do t'i hapë rrugën zhvillimit politik dhe ekonomik-shoqëror të vendit, do t'i çelë atij perspektivën e integritimit në organizmat ndërkombëtarë dhe në mënyrë të veçantë, do të krijojë mundësi më të mëdha për bashkëpunimin dhe integrimin e gjithanshëm me Republikën e Shqipërisë dhe me gjithë kombin shqiptar në tërësi si edhe në bashkimin e forcave tona shkencore për të mirën e shkencës e të kulturës sonë kombëtare. Duke qenë i bindur se Konferenca e sotme shkencore do të kontribuojë në ndriçimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u uroj organizatorëve dhe pjesëmarrësve të saj sukses të plotë.

Ju faleminderit.

